

Prishtinë: 07/03/2007

Kodi i ZRRE-së: D\_35\_2007

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Ligjit Nr. 2004/9 "Mbi Rregullatorin e Energjisë", dhe
2. Nenin 25.1 të "Rregullit mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji".

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në seancën e mbajtur më 07 Mars 2007 ka nxjerrë këtë:

## **VENDIM**

### **Për aprovimin e normës së interesit ditor: 0.04% dhe vjetor :14.65% për vitin 2007**

1. Neni 25.1 i Rregullit mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ka paraparë që Zyra e Rregullatorit për Energji ("ZRRE") mund të vendosë një normë interesi për pagesat e vona, bazuar në aplikacionin e furnizuesit.
2. Me 21 Shkurt 2007 KEK SH.A. / Divizioni i Furnizimit ka paraqitur në ZRRE aplikacionin për normën e interesit për pagesat e vona prej 14.65 % në vit, me normë ditore interesi prej 0.04%. Norma e interesit e kërkuar është e njëjtë me normën e interesit të miratuar në vitin 2006.
3. ZRRE ka shqyrtuar aplikacionet e KEK SH.A. dhe ka përllogaritur normën e interesit bazuar në të dhënat e KEK SH.A mbi normën e interesit dhe ka nxjerrë këtë vendim për të aprovuar normën e interesit siç është kërkuar nga KEK.SH.A.
4. Ky vendim do të botohet nga KEK SH.A, në të paktën një gazetë ditore lokale që ka qarkullim të gjerë në Kosovë, brenda 5 ditë pune pas njoftimit të ZRRE-së dhe botimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
5. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis gjuhëve, do të sundojë versioni në gjuhën shqipe.
6. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh prej miratimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
7. Ky Vendim hyn në fuqi datën e lëshimit ose datën e publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së
8. Ky Vendim është identik me vendimin e aprovuar në seancën publike të datës 30 Tetor 2006

